

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA / VLADA / GOVERNMENT MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE Ministarstvo Rada / Socijalne Zaštite / Ministry of Labour and Social Welfare Sektor: Arhiv / Sektor: Archive / Archive Sector	
Klasa Org. Org. Jedinita Org. Jona Nr. i Listave Br. statistika Nr. pages	Nr. Prot: Proj. Prot: Prot. No: 1680 Data: Datum: 08, 10, 20 Date:
Prishtine, Prishtine, Prishtine	



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
 QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
 MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE / MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE / MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE

MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE

KONTRATA

Titulli: Realizimi i Videos për promovimin e punësimit dhe shërbimeve të Agjencisë së Punësimit

Nr. i Prokurimit ¹	209-20-4835-2-3-6
Nr i brendshëm	MPMS-209/20/005/236

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit



KONTRATA

MINISTRIA E PUNES DHE MIREQENIES SOCIALE, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; dhe

"Contour Line" SH.P.K., Muharrem Fejza, 10000, Prishtina (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

Realizimi i Videos për promovimin e punësimit dhe shërbimeve të Agjencisë së Punësimit me numër Identifikues **209-20-4835-2-3-6, MPMS-209/20/005/236**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë Realizimi i Videos për promovimin e punësimit dhe shërbimeve të Agjencisë së Punësimit, në kuadër të detyrës së saj *Publikimi dhe Promovimi i Punësimit*, APRK synon të prodhoj 1 film promovues të cilin pastaj mëton ta publikoj përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit. Qëllimi i këtij filmi do të jetë promovimi i punësimit në tërësi dhe shërbimeve të këshillimit dhe integritetit të APRK-së për qytetarët e Republikës së Kosovës. Ky film duhet të jetë në gjatësi prej 2 deri në 5 minuta. Lokacionet e xhirimit të filmit do të jenë në vende të ndryshme në mbarë Kosovën dhe xhirimet pritet të zgjasin 10 deri 12 ditë pune. Para xhirimit, kontraktori duhet të ja prezantoj palës kontraktuese 4 skenare/ide të ndryshme në format të story board, dhe pas aprovimit nga menaxhmenti i APRK, të realizoj njërin nga këto propozime në format të filmit të shkurtër. Filmi duhet të xhirohet në cilësinë 4K dhe/ose në 4K RAËË. Sipas kërkesës së palës kontraktuese pas konsultimit me regjisorin, kërkohet që filmi të xhirohet me kamerat: RED, Ari Alexa apo të ngjajshme.

1.2 Kontrata hynë në fuqi me 08.10.2020 dhe përfundon 20 ditë pas lëshimit të urdhërbljes nga AK.

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se (20ditë).

1.4 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë per APRK

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP² (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: [6,090.00€] €; (Gjashtëmijë e Nëntëdhjetë euro e zero cent) Euro.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

² DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pas pranimit të tërë dërgesës

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i *shërbimeve* duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 2 muaj, pas pranimit të *furnizimeve*

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [*t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat*] brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së *furnizimeve* të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtrinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paafësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në *Gjykata ekonomike e Prishtinës* në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin ei identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë. **Komunikimet ne lidhje me projektin do të bëhen në mes të menaxherit të kontratës z. Shpëtim Kalludra i emëruar nga AK dhe menaxherit të projektit nga Operatori ekonomik.**

E hartuar në gjuhën [Shqip]³ në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.



Për Operatorin Ekonomik		Për Autoritetin Kontraktues	
Emri:	Arbër Gjoni	Emri:	Fel Pirri
Pozita:	Drejtor	Pozita:	Udhëheqësi i Drejtimit të projektit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	08.09.20	Data:	08.09.20
Vula:		Vula:	

³ Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

Numri i Prokurimit: 209/20/005/236 – Titulli Realizimi i Videos për promovimin e punësimit dhe shërbimeve të Agjencisë së Punësimit

Seksioni II. Formulari i PËRSHKRIMIT TË ÇMIMIT

Nr. i Artikullit.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi njesi DDP ⁵ - €	Çmimi total €	Koha e dërgesës
1.	“Realizimi i Videos për promovimin e punësimit dhe shërbimeve të Agjencisë së Punësimit”	Video	1	6090	6090	Sipas kerkesave kontraktuale
Totali i Përgjithshëm:					6090	

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK	
EMRI I KOMPANISË	CONTOUR LINE
ADRESA E PLOTE	MUHARREM FEJZA
PERFAQESUAR NGA:	
EMRI	ERËZA DEMJAHA
POZITA	DREJTOR
NENSHKRIMI	
DATA	11.09.2020
VULA	

⁵ Detyrimi i Dorëzimit është Paguar - Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare.